

Roli i Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit

Ministri i Drejtësisë, në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit bashkërendon punën për hartimin e politikave dhe përgatitjen e akteve ligjore dhe nënligjore për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit.

Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit është përgjegjës për kryerjen e verifikimit (hetimit administrativ) të denoncimeve/ankesave për praktika abuzive, korruptive apo arbitrare për zbatimin e ligjshmërisë, si dhe identifikimi i punonjësit e institucioneve, pjesë e Rrjetit të Koordinatorëve Antikorrupsion, të cilët, me veprime apo mosveprime, kanë kryer shkelje të akteve ligjore/nënligjore në fuqi, si dhe njëkohësisht zhvillimi i projekteve dhe i programeve në fushën kundër korrupsionit, planifikimi, koordinimi e përcaktimi i instrumenteve të domosdoshme për implementimin e politikave të fushës kundër korrupsionit.

Buletini elektronik është një mjet i gjerë komunikimi që synon të informojë nëpërmjet pasqyrit të një përmbledhjeje të aktiviteteve kryesore të zhvilluara nga Ministria e Drejtësisë në fushën antikorrupsion, mbi baza mujore.

Aktivitetet përgjatë muajit Tetor, 2023

Dy vjet aktivitet Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit

21.10.2023: Muaji tetor 2023 ka shënuar 2 vite aktivitet të Drejtorisë së Përgjithshme Antikorrupsion, duke krijuar një strukturë të rëndësishme për të rritur besimin publik dhe konsoliduar rezultatet në luftën kundër korrupsionit. Ky sukses është reflektuar në statistikat e punës, të cilat tregojnë rezultate domethënëse dhe një historik solid në përpjekjet e përbashkëta për të ndërtuar një shoqëri më të drejtë dhe transparente. Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit është një organ i qendëruar me funksionet të politikë-bërjes dhe të vendosjes së masave ndëshkimore për raste korrupsionit në organet e administratës publike. Për dy vite veprimtari, janë ndërmarrë 500 masa administrative për shkelje të rregullave të punonjësve publikë dhe 240 rekomandime të ofruara për të përmirësuar dhe unifikuar praktikat institucionale. Po ashtu, si pasojë e analizës së shkeljeve të gjetura, janë depozituar 46 kallëzime penale në organet e prokurorisë. Problematika të fushës së pronave, shërbimeve me publikun në tatime, në sektorët dhe zyrat e arsimit, gjendja civile, shërbime postare. Hartimi i një kuadri të ri strategjik antikorrupsion, krijimi i një kuadri të qëndrueshëm dhe rezultativ i performancës sektorëve me risk, integriteti në sektorin privat dhe bashkërendimi i politikave kombëtare antikorrupsion janë vëmendja e shtuar e aktivitetit të drejtorisë. Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit, ka një rol evident në rritjen e performancës së vendit me standartet e Bashkimit Europian, në kuadër të procesit të përafrimit dhe programimit të masave të ardhshme të veprimit.



Denonconi raste dhe praktika abuzive, në adresën: koordinatoriak@drejtesia.gov.al



Vendet e Ballkanit Perëndimor bashkë në Konferencën Rajonale “Mbi luftën kundër korrupsionit, pastrimin e parave dhe lehtësimin e përpjekjeve për rikuperimin e aseteve”

31.10.2023: Shkupi ishte vendi pritës i një ngjarjeje të rëndësishme rajonale për autoritete politike dhe përfaqësues të ekspertëve të fushës. Konferenca Rajonale “Mbi luftën kundër korrupsionit, pastrimin e parave dhe lehtësimin e përpjekjeve për rikuperimin e aseteve”, u organizua nën kujdesin e Kryesisë së OSCE-së së Shkupit, dhe bëri bashkë vendet e Europës Juglindore, të cilat ndanë eksperiencat dhe krijuan mjedisin e përbashkët për të punuar në sfidat kryesore të luftës kundër korrupsionit. Ministria e Drejtësisë, paraqiti përpjekjet dhe rezultatet e saj në luftën kundër korrupsionit, për Shqipërinë, me pjesëmarrjen e Drejtorit të Përgjithshëm të Antikorrupsionit, z. Florin Demollari. Arritjet e deritanishme të reformës në drejtësi, lehtësitë e procesit të digjitalizimit, partneriteti ndërkombëtar dhe vullneti për të rakorduar masat dhe veprimet për ndëshkimin e korrupsionit në fushën ekonomike, ishin fokusi i diskutimit. Të gjitha vendet pjesëmarrëse ndanë eksperiencat e tyre në zhvillimin dhe zbatimin e politikave efektive antikorrupsion. Ata gjithashtu shprehën gatishmërinë e tyre për të zhvilluar projekte të përbashkëta që do të rrisin ndikimin e tyre në luftën kundër korrupsionit si dhe prezantuan iniciativat dhe masat institucionale të ndërmarrura për të adresuar këtë problem të rëndësishëm. Ndërgjegjësimi i publikut dhe roli i tij në luftën kundër korrupsionit, për të pasur një publik të informuar dhe të përfshirë në nisma morrën dakordësinë e vendeve. Konferenca u përmbyll me një angazhim të përbashkët të shprehur të pjesëmarrësve, për të përsheptuar nismat kundër korrupsionit dhe forcuar bashkëpunimin rajonal.




Miratohet raporti i monitorimit të zbatimit të Planit të Veprimit Antikorrupsion, janar - qershor 2023

10.10.2023: Ekipi Tematik Antikorrupsion, nën drejtimin e Zëvendësministrit të Drejtësisë, znj. Adea Pirdeni, morri në shqyrtim, diskutoi dhe miratoi raportin e monitorimit të zbatimit të Planit të Veprimit Antikorrupsion, për periudhën janar - qershor 2023. Në takim morrën pjesë përfaqësues të institucioneve zbatuese të planit të veprimit, organizata partnerë të luftës kundër korrupsionit, gjithashtu. Ky raport monitorimi jep një informacion mbi progresin për 60 masa e 104 aktivitete të planifikuara për zbatim për periudhën janar - qershor 2023, që korrespondon edhe me vitin e fundit të zbatimit të planit të veprimit antikorrupsion. Nga monitorimi i kryer rezultojnë se janë zbatuar plotësisht 34 masa/59 aktivitete, pjesërisht 10 masa/6 aktivitete dhe nuk janë zbatuar 16 masa/39 aktivitete. Si arritje kryesore gjatë kësaj periudhe monitorimi mund të përmenden kryesisht: 2.827.371 përdorues për 1227 shërbime elektronike; 4030 rekomandime të pranuar dhe zbatuara dhe 6 vlerësime të jashtme të cilësisë të kryera nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë; vijimi i shtrirjes së Planeve të Integritetit në mënyrë kapilare në institucionet e varësisë të ministrive të linjës dhe 22 bashki; 110 procedime penale me 118 persona nën hetim, për veprat penale që lidhen me korrupsionin nga SPAK si dhe përdorimi i teknikave të posaçme në kryerjen e hetimeve proaktive në 988 raste; 84 procedime penale me 62 të pandehur për veprat penale në fushën e korrupsionit nga Prokuroria e Përgjithshme dhe 32,034,000.00 lekë, pasuri të sekuestruar për korrupsion nga AAPSK. Në vijim të miratimit të këtij raporti, gjatë muajit tetor ka nisur edhe puna për monitorimin e Planit të Veprimit Antikorrupsion, për periudhën korrik - shtator 2023.



Raportet e monitorimit mund t'i gjeni të publikuara në: <https://www.drejtesia.gov.al/raporte-monitorimi-2023/>

Strategjia e re Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, 2024 – 2030, pritet të finalizohet brenda vitit 2023



2-31.10.2023: Gjatë muajit tetor, Sekretariati Teknik i Drejtorisë së Përgjithshme Antikorrupsionit ka vazhduar punën në hartimin e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, me kohëzgjatje vitet 2024-2030. Kjo fazë finale e konsolidimit të paketës është duke u bashkërenduar me ekspertizën teknike të Delegacionit të Bashkimit Europian, në Shqipëri. Rezultati i këtij dokumenti është hartimi i një akti me informacion të plotë, për qëllimet e politikës (parandalim – ndëshkim – ndërgjegjësim), objektivet specifike (17 në total) dhe Plani i Veprimit me masa dhe aktivitete konkrete që duhet të ndërmerren. Plani i Veprimit do të ketë një kohëzgjatje 3-vjeçare, në zbatim, vitet 2024 – 2025 - 2026. Paketa e re strategjike antikorrupsion, do të reflektojë objektivat e institucioneve shqiptare në luftën kundër korrupsionit, rekomandimet e adresuara Shqipërisë nga procesi *screening*, dhe angazhimet e marra për zbatim deri në vitin 2030. Në fillim të vitit 2024, pritet të nisë procesi i konsultimit publik të dokumentit strategjik, për tu finalizuar me miratimin e saj brenda 4-mujorit të parë të vitit 2024. Strategjia e re Antikorrupsion, do të materializojë hapat e vendit në luftën kundër korrupsionit si dhe do ta përqasë kuadrin institucional në përputhje me agjendën 2030 të Shqipërisë.

Zhillohet mbledhja e Grupit Drejtues të Iniciativës Rajonale Antikorrupsion, në Moldavi

24 - 25.10.2023: Bashkëpunimi i nismave rajonale në luftën kundër korrupsionit mbledhi bashkë vendet anëtare të Iniciativës Rajonale Antikorrupsion – RAI, në takimin e Grupit Drejtues, për vitin 2023. Ministria e Drejtësisë, ndoqi takimin me Sekretarin e Përgjithshëm, z. Ismail Shehu, dhe Drejtorin e Përgjithshëm të Antikorrupsionit, z. Florin Demollari. Në këtë tryezë raportimi dhe diskutimi, vendet anëtare në RAI, ndanë eksperiencat e tyre në hartimin dhe zbatimin e politikave efektive antikorrupsion në vitin 2023. Gjithashtu u fokusuan në zhvillimin e projekteve të përbashkëta në këtë fushë, duke njohur rëndësinë e bashkëpunimit rajonal. Ecuria për të ardhmen kundër korrupsionit mbetet një sfidë e madhe dhe në përpjekje për tu rakorduar mes vendeve. RAI vijon të jetë një nivel bashkëpunimi i plotë dhe efektiv, në përpjekjet për të zvogëluar dhe eliminuar korrupsionin në rajon, si një synim i përbashkët i të gjitha vendeve pjesëmarrëse të rajonit.



Integriteti dhe etika në administratën publike si instrumenta të luftës kundër korrupsionit

27.10.2023: Ministria e Drejtësisë mori pjesë në një projekt bashkëpunimi për integritetin dhe etikën në administratën publike, të organizuar nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim. Projekti u zhvillua me pjesëmarrjen e 60 punonjësve të institucioneve qendrore në një përpjekje të përbashkët për të trajtuar integritetin dhe etikën në administratën publike, si pjesë esenciale e aktivitetit të tyre të punës. Hulumtimi u zhvillua përmes një metodologjie ndërkombëtare, e cila përfshiu tre sfera kritike: (I) rregullat e integritetit në administratën publike; (II) fshehja e korrupsionit si dhe (III) toleranca e korrupsionit. Pjesëmarrësit reagon në situata hipotetike të shkeljeve etike dhe parregullsive që mund të ndodhin gjatë proceseve të punës, duke përdorur pyetësorë të përgatitur me kujdes për të vlerësuar sjelljen e tyre në këto situata. Të dhënat e mbledhura gjatë këtij hulumtimi do të shërbejnë si bazë për hartimin e raporteve analitike dhe do të ofrojnë një analizë thelbësore mbi qëndrimet dhe sjelljet e punonjësve të administratës publike në lidhje me korrupsionin, etikën dhe rregullat e integritetit në vendin e punës.